



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
MK-79
Prishtinë, më 7 tetor 2009, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 7 TETOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Sllobodan Petroviq dhe Mufera Sinik.

Nga grupet parlamentare: Safete Hadergjonaj, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini dhe Xhezair Murati, kurse mungoi Bojan Stojanoviç.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Skënder Reçica dhe Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Naim Abazi, dhe Shefqet Rexhepi;

Nga NDI: Shefki Kastrati dhe

Nga OSBE: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me pikat shtesë që do të procedohen sipas radhës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 shtator 2009,
2. Propozimi i rendi të ditës për seancën plenare më 12 tetor 2009,
3. Propozimi i rendi të ditës për seancën plenare më 13 tetor 2009
4. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 shtator 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 22 shtator 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendi te ditës për seancën plenare më 12 tetor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pik veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **v e n d o s i** që seanca e ardhshme e Kuvendit të mbahet më 12 tetor 2009, në orën 10:00, me këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 30. 09. 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin sindikal,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës,
6. Shqyrtimi i Projekt-strategjisë kundër korrupsionit,
7. Debati për gjendjen tregtare ne vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet tjera,
8. Shqyrtimi i Raportit për monitorimin e Ligjit për mbeturina,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad-hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës,
10. Njoftimi me vendimin e Grupit Parlamentar të AKR-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Propozimi i rendi të ditës për seancën plenare më 13 tetor 2009

Kryesia, pasi diskutoi për secilën pik veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **v e n d o s i** që seanca e tjetër e ardhshme e Kuvendit të mbahet më 13 tetor 2009, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009,
2. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009,
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010, në bazë të qarkores së dytë të MEF-it 2010/02

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit lidhur me kërkesën buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010, në bazë të qarkores së dytë të MEF-it /2010/02/ shtyhet për një mbledhje të veçantë të Kryesisë së Kuvendit, në të cilën duhet të marrin pjesë kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa dhe ministri i Ekonomisë dhe i Financave.

3.2 Shqyrtimi i Propozimit të Grupit Parlamentar të AKR-së për emërimin e deputetes Suzanë Novobërdaliu në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, në vend të deputetit Shkumbin Demaliaj

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Grupit Parlamentar të AKR-së, vendosi që atë ta radhisë në rend dite të seancës plenare, për shqyrtim.

3.3 Shqyrtimi Propozimit i Grupit Parlamentar të AKR-së për emërimin e deputetes Suzanë Novobërdaliu, në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Riza Smaka

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Grupit Parlamentar të AKR-së, për emërimin e deputetes Suzanë Novobërdaliu, në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri vendosi që atë ta radhisë në rend dite të seancës plenare, për shqyrtim.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për kompensimin e mëditjeve të udhëtimit zyrtar në Ohër

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet qëndrimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media: Esat Brajshori, Synavere Rysha, Hajredin Hyseni, Anita Morina dhe Dragan Dimiq në Ohër, Maqedoni, prej 1 deri më 4 tetor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritime Evropiane për kompensimin e mëditjeve të vizitës zyrtare në Këshillin e Evropës, në Strasburg

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve Komisionit për Integritime Evropiane: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri dhe Branislav Grbiç në Këshillin e Evropës, në Strasburg, prej 27 deri më 30 shtator 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Radmila Vujović për kompensimin e mëditjeve të udhëtimit zyrtar në Aman, Jordani

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Kryesia nuk mbështet kërkesën e deputetes Radmila Vujović për kompensimin e mëditjeve të udhëtimit në Aman, Jordani, me arsyetimin se kërkesa nuk është në pajtim me vendimin Kryesisë së Kuvendit, nr. 03-V-094, dt. 04.11.2008.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Radmila Vujoviq për kompensimin e mëditjeve të udhëtimit zyrtar në Sarajevë, Bosnjë e Hercegovinë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes Radmila Vujoviq në Sarajevë, Bosnjë e Hercegovinë, prej 15 deri më 16 tetor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurën në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

4. Të ndryshme

4.1 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad-hoc parlamentar për emërimin anëtarëve të Bordit të Radio -Televizionit të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e Komisionit ad-hoc parlamentar, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni ad-hoc parlamentar që deri në seancën plenare të caktuar për 12 tetor 2009, të procedojë me përzgjedhjen e plotë të përbërjes së Bordit, duke hyrë në votim edhe për (3) tre anëtarë të nominuar nga lista e Komisionit ad-hoc të Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim .

4.2 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Edita Tahiri për kompensim të mëditjeve shtesë për udhëtimin zyrtar në Cavtat, Kroaci, më 8 – 10 tetor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Kryesia nuk mbështet kërkesën e deputetes Edita Tahiri për kompensimin e mëditjeve të udhëtimit në Cavtat, Kroaci, me arsyetimin se kërkesa nuk është në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr.03-V-09, dt. 04.11.2009.

4.3 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Sadik Idriz për kompensim e të shpenzimeve të udhëtimit dhe mëditjet shtesë për udhëtimin zyrtar në Slloveni, më 6 -7 tetor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Kryesia nuk mbështet kërkesën e deputetit Sadik Idriz për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të mëditjeve për të marrë pjesë në Konferencën dyditorë në Lubjanë, me arsyetimin se kërkesa nuk është në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 03V-09, dt. 04.11.2998.

4.4 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Arsim Rexhepi për kompensim të shpenzimeve për udhëtim zyrtar në Aman, Jordani

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Kryesia nuk mbështet kërkesën e deputetit Arsim Rexhepi për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në Aman, Jordani, me arsyetim se kërkesa nuk është në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 03-V-094, dt. 04.11.2008.

4.5 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Arsim Rexhepi për kompensim të shpenzimeve për udhëtim zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

Kryesia nuk mbështet kërkesën e deputetit Arsim Rexhepi për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në Gjermani, me arsyetim se kërkesa nuk është në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 03-V-094, dt. 04.11.2008.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale